



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 88, Datë 31.03.2021

MBI

**KËRKESËN E ZYRTARIT TË PAJTUESHMËRISË TË OST SH.A.
PËR SHTYRJEN E AFATIT TË DORËZIMIT TË RAPORTIT VJETOR TË
PAJTUESHMËRISË SË OPERATORIT TË SISTEMIT TË TRANSMETIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar, nenit 15, të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.06.2016, kreut VI, gërma C, pika 1, të Programit të Pajtushmërisë së Operatorit të Sistemit të Transmetimit të Energjisë Elektrike, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr .103 datë 30.04.2018, bordi i ERE, në mbledhjen e tij të datës 31.03.2021, mbasi shqyrtoi Informacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi kërkesën e zyrtarit të pajtushmërisë të OST sh.a., për shtyrjen e afatit të dorëzimit të raportit vjetor të pajtushmërisë”,

Konstatoi se:

- Bordi i ERE, me vendimin nr. 103, datë 30.04.2018, ka vendosur të miratojë Programin e Pajtushmërisë së Operatorit të Sistemit të Transmetimit për Energjinë Elektrike.
- Në kreun VI, gërma C, pika 1, të këtij programi, përcaktohet si vijon: Çdo vit, jo më vonë se data [31 mars], zyrtari i pajtushmërisë duhet të përgatisë dhe dorëzojë në ERE një raport për pajtushmërinë e OST-së me këtë Program, i cili duhet të publikohet në faqen e internetit të OST-së dhe të ERE-s.
- Me e-mailin e dërguar në ERE në datën 26.03.2021, Zyrtari i Pajtushmërisë së OST sh.a., i është drejtuar ERE-s me kërkesën për shtyrje të afatit të dorëzimit të raportit të pajtushmërisë së OST sh.a për vitin 2020, me 7 (shtatë) ditë pune nga data 31 Mars që është afati i fundit për dorëzimin e tij. Kjo kërkesë vjen si rezultat i gjendjes shëndetësore të ditëve të fundit të Zyrtarit të Pajtushmërisë së OST sh.a., i cila nga testimi i datës 23 Mars 2021, ka rezultuar pozitiv ndaj COVID-19.
- Duke marrë në konsideratë gjendjen e Zyrtarit të Pajtushmërisë për shkak të infektimit me COVID - 19, vlerësojmë marrjen parasysht të kërkesës së Zyrtarit të Pajtushmërisë

për të shtyrë afatin e dërgimit të Raportit Vjetor për vitin 2020, por duke caktuar një kohë prej 14 (katërbëdhjetë) ditësh pune, duke filluar nga data 31 Mars. Zgjatja e afatit të kërkuar nga Zyrtari i Pajtueshmërisë sugjerohet për t'i dhënë mundësinë e dorëzimit të raportit vjetor, pas rikuperimit të plotë nga pandemia COVID-19. Sikurse jemi në dijeni, shërimi nga kjo pandemi kërkon një periudhë më të gjatë sesa 7 (shtatë) dite pune, për këtë arsye mendojmë se është e arsyeshme zgjatja e afatit të kërkuar nga Zyrtari i Pajtueshmërisë se OST sh.a deri në datën 20.04.2021.

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të pezullojë zbatimin e afatit të parashikuar në kreun VI, gërma C, pika 1, të Programit të Pajtueshmërisë së Operatorit të Sistemit të Transmetimit të Energjisë Elektrike, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 103, datë 30.04.2018, deri në datën 20.04.2021.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë Zyrtarin e Pajtueshmërisë së Operatorit të Sistemit të Transmetimit të Energjisë Elektrike, Sekretariatit e Komunitetit të Energjisë, si dhe OST sh.a., për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE

Petrit AHMETI